



Pranimë / Primesha / Received	27-09	2022	2	viti / god / year
Organ / Organ / Organi	Instit / Inst / Inst	Shtesa / Prilog / Appendix	Sasia / Kolicina / Quantity	
SKMSTHC 2463/2022			1/4	



Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
 NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
 INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.221/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi- Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë, me Flakron Gashi -Zyrtar i lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.221/2022,të datës 11.03.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi:

kundër organit të punësimit/Komuna e Junikut, në çështjen juridike “ndërprerje e marrëdhënies së punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 27.04.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.221/2022 e datës 11.03.2022 e parashtruar nga ankuesi

II. MBETET në fuqi Vendimi me numër 1-180/1837 i datës 07.03.2022 i Kryetarit të Komunës së Junikut.

A r s y e t i m

Ankuesi me datë 11.03.2022, me numër protokolli 1289/2022, ka parashtruar ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore, kundër vendimit me numër 1-180/1837, të datës 07.03.2022, të Kryetarit të Komunës së Juniku, lidhur me “ndërprerjen e marrëdhënies së punës”.



Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 16.03.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Komuna e Junikut. Ndërsa Këshilli me datë 31.03.2022, ka pranua nga Komuna e Junikut përgjigjen në kërkesë me numër protokoli:1840/2022, se bashku me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike ,për marrjen e vendimit meritator ka administruar këto prova: Ankesën A Nr. 221/2022, e datës 11.03.2022, e parashtruar nga ankuesi me numër protokoli 1289 /2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 26.11.2021, me numër protokoli 1-180/10754, i Kryetarit të Komunës së Junikut; Vendimi i datës 05.01.2018, me numër protokoli 1-180/248, i Kryetarit të Komunës së Junikut; Vendimi i datës 16.04.2021, me numër protokoli 1-004/2774, i Kryetarit të Komunës së Junikut; Vendimi i datës 10.01.2014, me numër protokoli 1-004/277, i Kryetarit të Komunës së Junikut; Vendimi i datës 07.03.2022, me numër protokoli 1-180/1837, i Kryetarit të Komunës së Junikut, lidhur me ndërprerjen e marrëdhënies së punës; Vendimi i datës 24.02.2021, me numër protokoli 1-180/1554, i Kryetarit të Komunës së Junikut; Ndryshimi dhe plotësimi i Akt Emërimit i datës 07.05.2012;Akt Emërimi i datës 04.01.2012; Aprovimi i titujve i datës 03.05.2013, i Ministrisë së Administratës Publike; Kërkesë e datës 03.04.2013;lista e pagave nga data 01.05.2013, deri me datë 31.05.2013; Vendimi i datës 01.06.2011,me numër protokoli 01/32, i Kryetarit të Komunës së Junikut; Kontrata e marrëdhënies së punës e datës 01.06.2011;Përshkimi i detyrave të punës; Kontrata e marrëdhënies së punës e datës 06.05.2010;Rekomandim i datës 09.08.2010; Kontrata e marrëdhënies së punës e datës 06.08.2011; Kërkesa për punësim e me numër protokoli 11/01, e datës 07.04.2010, me shkresat e bashkangjitura; Formuari për listën e ngushtë; intervista përfundimtare e datës 30.04.2010; Renditja përfundimtare e Zgjedhjes Finale; Raporti për Zgjedhjen e Zyrtarit të Prokurimit; Regjistrimi i Kërkesave të pranuar; Konkursi i datës 26.03.2010; Përgjigje në ankesë e datës 31.01.2022, me numër protokoli 1749, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi që ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e pabazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon Kryetari i Komunës së Junikut përmes vendimit numër 1-180/1837 të datës 07.03.2022 i ka ndërprerë marrëdhënien e punës në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi si dhe pretendimin që të kthehet në ndonjë pozitë që i takon me ligj dhe të ekzekutohet vendimi A.nr.1223/2021 i KPMSHCK-së.

Kolegji po ashtu në bazë të shkresave të lëndës ka konstatuar se Kryetari i Komunës së Junikut pasi që ka pranuar vendimin e KPMSHK-së A. Nr. 1223/2021 me qëllim të zbatimit të tij sipas obligime ligjore ka nxjerr vendimin Nr. 01/28 të datës 24.02.2022 me të cilin vendim e risistemon ankuesin në pozitën "Shef i Zyrës së Prokurimit" ku është paraparë koeficienti nëntë (9), ndërsa ankuesi me datë 01.03.2022 e ka njoftuar Kryetarin e Komunës së Junikut, se nuk mund të plotësoj kushtet për të shërbyer në pozitën "Shef i Zyrës së Prokurimit", pasi që i ka skaduar certifikata profesionale dhe se pajtohet që të angazhohet edhe në ndonjë pozitë tjetër me të ultë, ndërsa me qëllimin e ri sistemimit të punësuarit Komuna e Junikut ka analizuar dosjen e

ankuesit, pas analizimit të dokumentacionit Komuna e Junikut ka gjetur së ankuesi ka themeluar marrëdhënien e punës, sipas konkursit të datës 23.03.2010, për vendin e punës "Zyrtar i Prokurimit", në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, sepse ankuesi nuk i ka plotësuar kushtet e konkursit rrjedhimisht nuk ka qenë i diplomuar dhe nuk ka poseduar certifikatë të prokurimit për pozitën "Zyrtar i Prokurimit" andaj mbi këtë bazë kryetari i Komunës së Junikut ka nxjerrë vendimin me numër:1-180/1837 të datës 07.03.2022 njëherit ia ka ndërprerë marrëdhënien e punës ankuesit

Lidhur me arsyetimin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës së ankuesit nga Kryetari i Komunës së Junikut, Kolegji ka gjetur se Komuna e Junikut me datë 26.03.2010 e kishte publikuar konkursin për pozitën "Zyrtar i Prokurimit" duke u bazuar në Rregulloren 2001/36 mbi Shërimin Civil, Urdhëresës Administrative Nr. 2003/2 mbi Implementimin e Rregullores Nr. 2001/36 dhe Urdhëresës Administrative MSHP/DASHÇ Nr. 2003/1, ndërsa kushtet e konkursit kanë qenë **kualifikimi, përgatitje superiore**, dhe pas zhvillimit të procedurës së rekrutimit, me datë 30.04.2010 Komisioni Intervistues, ka përzgjedhur kandidatin _____ në pozitën "Zyrtar i Prokurimit", pasi që e kishte vlerësuar me dyqind e gjashtëdhjetë (260) pikë. Ndërsa, pasi që ka analizuar dosjen e ankuesit përkatësisht kërkesën e punësimit të datës 07.04.2010 me numër protokolli 11/01, Kolegji ka konstatuar se i njëjti me rastin e aplikimit respektivisht përzgjedhjes nuk ka poseduar përgatitje superiore ndërsa ka qenë absolvent në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike, me çka nënkuptohet se ankuesi nuk i ka plotësuar kushtet sipas konkursit të datës 26.03.2010, të publikuar nga Komuna e Junikut.

Me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë se pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative neni 55 paragrafi 1 dhe 3 i cili përcakton se: "1. Një akt administrativ i paligjshëm për arsye të tjera nga ato ta parapara nga neni 54 i këtij Ligji, mund të anulohet apo të shfuqizohet, me qëllimin për të vendosur ligjshmërinë 3. Pala përfituese nuk do të vlerësohet në mirëbesim nëse ka qenë në dijeni të shkaqeve të paligjshmërisë së aktit, ose nuk ka qenë në dijeni të tyre për shkak të pakujdesisë së rëndë apo nëse akti është nxjerrë bazuar në informacionin materialisht të gabuar apo jo të plotë, të dhënë nga vetë pala", dhe ka konstatuar se kryetari i Komunës së Junikut me rastin e nxjerrjes së vendimit me numër:1-180/1837 të datës 07.03.2022 mbi bazën e të cilit ankuesit i ka ndërprerë marrëdhënien e punës ka vepruar në pajtueshmëri me nenin 55 paragrafi 1 dhe 3 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, pasi që Komuna e Junikut me rastin e zhvillimit të procedurës së rekrutimit dhe përzgjedhjes së kandidatit për pozitën "Zyrtar i Prokurimit" ka vepruar në kundërshtim me nenin 4 paragrafi 4.2 pika a,b,c Urdhëresës Administrative NR. 2003/2 Zbatim i Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/36 mbi Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se: "Shpalljet për vendet e lira të punës duhet të përfshijnë informatat e mëposhtme:(a) Titullin e postit i cili shpallet;(b) Përshkrimin përmbledhës të punëve;(c) Kualifikimet e kërkuara" sepse kandidati i përzgjedhur nuk i ka plotësuar kushtet e përgjithshëm dhe të veçanta të konkursit, andaj në pajtim me nenin 53 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: "Një akt administrativ mund të anulohet apo shfuqizohet, sipas detyrës zyrtare, nga organi publik që ka kompetenca të nxjerrë aktin, nga organi i tij mbikëqyrës apo nga një organ tjetër i përcaktuar shprehimisht me ligj" me qëllim të kthimit të ligjshmërisë siç është pasqyruar edhe më lartë në arsyetim.

Po ashtu, Kolegji konstaton se Kryetari i Komunës së Junikut me vendimin e datës 07.03.2022 me numër protokolli 1-180/1837, me të cilin vendim ka anuluar Akt Emërimin e ankuesit 04.01.2012,

me numër protokoll Nr. 11/2012 si dhe ndryshimin dhe plotësimin të akt emërimit e datës 07.03.2013 ka vepruar edhe në pajtim me nenin 60 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet se: "Marrëdhënia e punës në Shërbimin Civil përfundon për shkak të ligjit, kur: 1.4. konstatohet pavlefshmëria e aktit të emërimit", ngase aktet e lartcekura e kishin për bazë fillestare kontratën e punës të datës 06.05.2010 e cila ishte lidhur pas procedurës së rekrutimit ku ishte konstatuar se ishte përcjellë me shkelje të theksuara të dispozitave ligjore në fuqi.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi që i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit, ka analizuar provat dhe faktet relevante një nga një, veç e veç dhe së bashku në tërësi dhe pasi ka konstatuar saktë gjendjen faktike dhe bazën juridike lidhur me ndërprerjen e marrëdhënies së punës për ankuesin nga Kryetari i Komunës së Junikut, ka ardhur në përfundimin se pretendimet ankimore të ankuesit lidhur me ndërprerjen e marrëdhënies së punës janë të pa bazuara.


Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenit 132 paragrafit 2 të Ligjit Nr.05/L-031 Për procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.221/2022

Flakron GASHI



Procesmbajtës



Eshref SHABANI
Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Junikut;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Junikut dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

